



VENDIM

Nr. 74, Datë 08.06.2015

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LIÇENSËS
SË SHOQËRISË YLLIAD SH.P.K. NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.
108, DATË 22.12.2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “g”; 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1 gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.06.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “a”; “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI